



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO**  
**KUVENDI - SKUPŠTINA - ASSEMBLY**

**Legjislatura III**

---

Kryesia e Kuvendit  
P-007  
Prishtinë, më 21 shkurt 2008, në orën 12:00  
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

**PROCESVERBAL**

**I MBLEDHJES SË KRYESISË TË KUVENDIT ME KRYETARËT E GRUPEVE  
PARLAMENTARE, TË MBAJTUR MË 21 SHKURT 2008**

**Në mbledhje morën pjesë:** Jakup Krasniqi, kryetar i Kuvendit dhe anëtarët e Kryesisë: Xhavit Haliti, Sabri Hamiti, Ibrahim Gashi, Nexhat Daci, Naim Maloku dhe Xhezair Murati, kurse munguan Eqrem Kryeziu dhe Slllobodan Petroviq.

Nga grupet parlamentare: Ramë Buja, Ibrahim Makolli, Lulzim Zeneli, Zylfi Merxha dhe Ardian Gjini.

**Në mbledhje ishin të pranishëm:**

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Sali Rexhepi, Thëllënza Arifi dhe Sherif Konjufca;

Nga Kabineti i Kryetarit të Kuvendit: Mehmet Hajrizi, Eshref Vishi dhe Ismet Hajrullahu;

Nga NDI-ji: Rinor Beka dhe Ian Perkins, dhe

Nga OSBE-ja: Floriana Shala.

Mbledhjen e kryesoi **Jakup Krasniqi**, Kryetar i Kuvendit të Kosovës.

**Kryetari** hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës, si dhe me materialet e shpërndara për këtë mbledhje.

Kryesia, me propozimin e Kryetarit, miratoi këtë

### **R e n d d i t e:**

1. Shqyrtimi i Strategjisë legjislative të Qeverisë së Kosovës për vitin 2008;
2. Propozimi i rendit të ditës për seancën e ardhshme plenare;
3. Shqyrtimi i rekomandimeve dhe i kërkesave; dhe
4. Të ndryshme.

### **1. Shqyrtimi i Strategjisë legjislative të Qeverisë së Kosovës për vitin 2008**

**Kryetari** i informoi anëtarët e Kryesisë dhe kryetarët e grupeve parlamentare me Strategjinë Legjislative të Qeverisë për vitin 2008, e cila duhet t'u shpërndahet të gjithë deputetëve të Kuvendit.

### **2. Propozimi i rendit të ditës për seancën e ardhshme plenare**

**Kryesia**, pasi i shqyrtoi përgatitjet e nevojshme për secilën pikë, veç e veç, vendosi që seanca e ardhshme plenare të mbahet (fillojë) më 26 shkurt 2008 dhe të vazhdojë gjatë tërë javës, deri sa të shqyrtohen të gjitha pikat e rendit të ditës.

Seanca do t'i zhvillojë punimet me orar të ri. Debatimi për shqyrtimin e projektligjeve do të zhvillohet prej orës 10:00 deri në orën 14:00. Pauzë për drekë 14:00 deri 16:00. Në orën 16:00 seanca do t'i vazhdojë punimet me votimin e projektligjeve, që janë shqyrtuar para dite.

**Kryesia** vendosi t'ia propozojë Kuvendit këtë

### **Rendi i ditës:**

1. Miratimi i procesverbaleve të seancave të mëparshme,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Shqyrtimi i kërkesës së Grupit Parlamentar për zëvendësimin e anëtarit të Komisionit për Buxhet dhe Financa,
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit të përkohshëm penal të Kosovës,
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit të përkohshëm të procedurës penale të Kosovës,
6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për përfitimimin e ish zyrtarëve të lartë,
7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për kooperativat e bujqve, nr. 2003/9,
8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për përdorimin civil të eksplozivëve,

9. Shqyrtimi i parë i Projektligji për procedurën kontestimore,
10. Shqyrtimi i parë i Projektligji për procedurën përmbartimore,
11. Shqyrtimi i parë i Projektligji për deklarimin dhe prejardhjen e pasurisë së zyrtarëve të lartë publikë,
12. Shqyrtimi i parë i Projektligji për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit mbi ekzekutimin e sanksioneve penale,
13. Shqyrtimi i parë i Projektligji për procedurën jokontestimore,
14. Shqyrtimi i parë i Projektligji për parandalimin e pastrimit të parave,
15. Shqyrtimi i parë i Projektligji për Noterinë ,
16. Shqyrtimi i parë i Projektligji për vlerësimin strategjik mjedisor,
17. Shqyrtimi i parë i Projektligji për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për skemën sociale,
18. Shqyrtimi i parë i Projektligji për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për Inspektoratin e Punës,
19. Shqyrtimi i parë i Projektligji për përkrahjen materiale të familjeve dhe fëmijëve me aftësi të kufizuara të përhershme,
20. Shqyrtimi i parë i Projektligji për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore,
21. Shqyrtimi i parë i Projektligji për ndihmë shtetërore,
22. Shqyrtimi i parë i Projektligji për ushqimin,
23. Shqyrtimi i parë i Projektligji për provimin përfundimtar dhe të maturës,
24. Shqyrtimi i parë i Projektligji për rehabilitimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara,
25. Shqyrtimi i parë i Projektligji për eficientësinë e energjisë,
26. Shqyrtimi i parë i Projektligji për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për mbështetjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme,
27. Shqyrtimi i parë i Projektligji për tatimin në vlerën e shtuar,
28. Shqyrtimi i parë i Projektligji për modifikimin gjenetik,
29. Shqyrtimi i parë i Projektligji për vlerësimin e ndikimit në mjedis,
30. Shqyrtimi i parë i Projektligji për taksën e vendosjes,
31. Shqyrtimi i parë i Projektligji për tokën ndërtimore, privatizimin dhe dhënien me qira
32. Shqyrtimi i parë i Projektligji për Inspektoratin e Bujqësisë,
33. Shqyrtimi i parë i Projektligji për mbrojtjen e mjedisit.

Në vazhdim, Kryesia i zhvilloi punimet pa praninë e kryetarëve të grupeve parlamentare.

### **3. Shqyrtimi i rekomandimeve dhe i kërkesave**

#### **3.1 Shqyrtimi i Projekt-Rregullores për organizimin dhe funksionimin e Kryesisë së Kuvendit**

Shqyrtimi i Projekt-Rregullores për organizimin dhe funksionimin e Kryesisë së Kuvendit u shty për mbledhje tjetër të radhës.

#### **3.2 Shqyrtimi i kërkesës së KRPP-së për themelimin e Organit Shqyrtues të Prokurimit**

Kryesia, pasi shqyrtoi kërkesën e KRPP-së për themelimin e Organit Shqyrtues të Prokurimit, nxori këtë

### **P Ë R F U N D I M**

Kërkohe nga Qeveria e Republikës së Kosovës, në bazë të autorizimeve të Ligjit për prokurimin publik, t'ia propozojë Kuvendit emrat e kandidatëve për anëtarë të Organit Shqyrtues të Prokurimit.

#### **3.3 Shqyrtimi i kërkesës së Zyrës së Rregullatorit të Energjisë për emërimin e dy anëtarëve të Bordit të saj**

**Kryesia**, pasi shqyrtoi kërkesën e Zyrës së Rregullatorit të Energjisë, nxori këtë

### **P Ë R F U N D I M**

Kërkohe nga Qeveria e Republikës së Kosovës, në bazë të autorizimeve të Ligjit për Rregullatorin të Energjisë, t'ia propozojë Kuvendit emrat e kandidatëve për anëtarë të Bordit të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë.

#### **3.4 Shqyrtimi i kërkesës së Këshillit të Agjencisë Kundër Korrupsionit për sqarimin e dispozitave ligjore lidhur me mëditjet e anëtarëve të saj**

**Kryesia**, pasi shqyrtoi kërkesën e Këshillit të Agjencisë Kundër Korrupsionit, nxori këtë

### **P Ë R F U N D I M**

Shuma e mëditjeve për kryesuesin, zëvendëskryesuesit dhe për anëtarët e tjerë të Këshillit të Agjencisë Kundër Korrupsionit të caktohet në bazë të Udhëzimit Administrativ të Qeverisë për unifikimin e pagesave nr.12/2007.

#### **3.5 Shqyrtimi i kërkesës së kryetarëve të grupeve parlamentare të AKR-së dhe të LDD-së lidhur me pajisjen e zyrave të tyre me inventar**

**Kryesia**, pasi shqyrtoi kërkesat e kryetarëve të grupeve parlamentare të AKR-së dhe të LDD-së, nxori këtë

### **P Ë R F U N D I M**

1. Kryesia mbështet kërkesat e grupeve parlamentar të AKR-ës dhe të LDD-së.
2. Kryesia ngarkoi Administrata e Kuvendit, që në afatin sa më të shkurtë, t'i pajis zyrat e grupeve parlamentare me inventar të nevojshëm për funksionimin e tyre.

#### **3.6 Shqyrtimi i kërkesës së deputetit (ish-kryetar i Kuvendit) Kolë Berisha për t'ia ndarë një zyrë pune**

**Kryesia**, pasi diskutoi lidhur me kërkesën e ish-kryetarit të Kuvendit, Kolë Berisha, ngarkoi Administratën e Kuvendit, që për mbledhjen e ardhshme të Kryesisë, ta sigurojë transkriptin nga mbledhja e Kryesisë, në të cilën është diskutuar edhe për kërkesën e ish-kryetarit të Kuvendit, Nexhat Daci, për të vendosur edhe për këtë kërkesë.

### **3.7 Shqyrtimi i kërkesës së kryetares së Komisionit për Integritet Evropian për t'ia darë një zyrë pune**

Kryesia, pasi shqyrtoi kërkesën e Komisionit për Integritet Evropian, nxori këtë

#### **P Ë R F U N D I M**

1. Kryesia në parim mbështet kërkesën e Komisionit për Integritet Euroatlantike.
2. Ngarkohet Administrata e Kuvendit që t'i shikojë mundësitë për sigurimin e zyrave të punës për të gjitha komisionet parlamentare.

### **3.8 Shqyrtimi i kërkesës së ish-anëtarëve të Kryesisë së Kuvendit Gazmend Muhaxheri dhe Bislim Hoti.**

Kryesia, pasi i shqyrtoi kërkesat e ish- anëtarëve të Kryesisë së Kuvendit, nxori këtë

#### **P Ë R F U N D I M**

1. Kompensimi i ardhurave për ish-anëtarët e Kryesisë së Kuvendit: Gazmend Muhaxheri dhe Bislim Hoti të bëhet në shumën e pagës së deputetit, konform rregullave 2.1 dhe 2.2 të Shtojcës numër 2 të Rregullores së Punës të Kuvendit.
2. Ngarkohet Administrata e Kuvendit ta zbatojë këtë vendim.

## **3 Të ndryshme:**

### **3.1 Njoftim me kërkesën e banorëve të fshatit Lajthishtë**

Kryesia ngarkoi Komisionin për të Drejta e Njeriut dhe për Peticione që ta shqyrtojë kërkesën e banorëve të fshatit Lajthishtë dhe Kryesisë t'ia paraqesë një informatë lidhur me të.

### **3.2 Njoftim me kërkesën e Nexhmedin Spahiut lidhur me ndërprerjen e transmetimit të TV Mitrovica**

**Naim Maloku** i informoi anëtarët e Kryesisë lidhur me kërkesën e cekur më lart, të cilën e kishte shqyrtuar Komisioni për Shërbime Publike, Administratë Lokale dhe Media.

Kryesia ngarkoi Komisionin Funkcional që ta përgatitë dhe Kryesisë t'ia paraqesë një informatë lidhur me kërkesën e TV Mitrovica.

### **3.3 Shqyrtimi i çështjes së zgjedhjes së Avokatit të Popullit**

**Kryetari** i informoi anëtarët e Kryesisë me rrjedhën e konkursit për zgjedhjen e Avokatit të Popullit gjatë mandatit të legjislaturës së dytë.

**Kryesia**, pasi shqyrtoi çështjes së zgjedhjes së Avokatit të Popullit, mori këtë

#### **V E N D I M**

1. Të shpallet konkursi për zgjedhjen e Avokatit të Popullit dhe të zëvendësit kryesor të tij, në pajtim me Rregullat procedurale për zgjedhjen e Avokatit të Popullit dhe të zëvendësit kryesor të tij.
2. Ngarkohet Administrata e Kuvendit t'i marrë gjitha veprimet procedurale për shpalljen e konkursit për zgjedhjen e Avokatit të Popullit dhe të zëvendësit kryesor të tij.

### **3.4 Njoftimi i GP të AKR për ndërrimin e anëtarit të Komisionit për Buxhet dhe Financa**

**Kryesia** vendosi që njoftimi i Grupit Parlamentar të AKR-së për zëvendësimin e anëtarëve të Komisionit për Buxhet dhe Financa ta radhisë në rend dite të seancë së ardhshme plenare.

### **3.5 Shqyrtimi i kërkesës së kryetares së Komisionit për Integritet Evropian për lejimin e udhëtimit zyrtar për në Slloveni**

**Kryesia**, pasi shqyrtoi kërkesën e cekur më lart, nxori këtë

#### **P Ë R F U N D I M**

1. Dy deputetë, anëtarë të Komisionit për Integritet Evropian, mund të marrin pjesë në takimin e Asamblesë së Evropës Perëndimore në Lubjanë, Slloveni.
2. Kuvendi i Kosovës nuk merr përsipër të përballojë asnjë shpenzim lidhur me udhëtimin e cekur më lart.

**Kryetari** e deklaroi mbledhjen të mbyllur në orën 14:15.

Kryetari i Kuvendit të Kosovës  
**Jakup KRASNIQI**

---

E hartoi:

**Divizioni i Çështjeve Plenare dhe Procedurale**